



Adresa: Qendra Zejtare 64/B, Pejë, Kosovë

Tel: +377 (0)44 111 408

+377 (0)44 139 567

+377 (0)44 142 895

Email: [syriivizionit@hotmail.com](mailto:syriivizionit@hotmail.com), [vizionipe@hotmail.com](mailto:vizionipe@hotmail.com)

[www.syriivizionit.net](http://www.syriivizionit.net)

Nr. i regjistrimit: 5101044-2

Emri: "Syri i Vizionit"

Statusi: Shoqatë

Data e regjistrimit : 17 Shtator 2001

Personi kontaktues:

Veton MUJAJ: +377 (0)44 111 408, e-mail: [vetonm@yahoo.com](mailto:vetonm@yahoo.com)

Emri i Bankës: ProCredit Bank Kosova Peja

Adresa e Bankës: Rruga e Herojëve Nr.6

Sëift kodi: MBKOYU22

Numri i xhirollogarisë: 1130-085368-0001-27

Bartësi i Xhirollogarisë: NGO "Syri i Vizionit"

# ORGANIZATA JO QEVERITARE "SYRI I VIZIONIT"

## RAPORTI VJETOR 2003

### Përmbajtja:

- Organizimi i Brendshëm & Aspektet e Menaxhimit
- Projektet kryesore të zhvilluara gjatë vitit 2003
- Raportet Financiare 2003
- Qendrueshmeria
- Prespektivat për vitin 2004

A) Organizimi i Brendshëm & Aspektet e Menaxhimit

## Organizata Jo Qeveritare “Syri i Vizionit” (SiV)

Numri i Regjistrimit (në UNMIK) OJQ-së: 510144-2

Data e Regjistrimit: 17 Shtator 2001

Adresa: Qendra Zejtare 64/B Pejë

Email: [syriivizionit@hotmail.com](mailto:syriivizionit@hotmail.com), [vizionipe@hotmail.com](mailto:vizionipe@hotmail.com)

Personi kontaktues: Veton Mujaj, Pejë, Drejtori Egzekutiv i Organizatës

## Informatat mbi Organizatën Jo Qeveritare “SiV”

### Organizata Jo Qeveritare “Syri i Vizionit”

OJQ “Syri i Vizionit”, me zyrë në Pejë ka filluar të implementojë projekte në periudhën e pasluftës 1999 me fokusim primar në media dhe komunikim, me publikimin e revistës “Vizioni” për fillim në rajonin e Pejës e më pas në mbarë Kosovën. Së pari filloi me një grup joformal të rinjsh, duke zhvilluar një varg të gjërë projektesh me shkallë të ulët. Duke iu falenderuar punës së madhe dhe entuziazmit të një grupi prej 40 aktivistëve të grupmohave 18 deri 27 vjeçare, “Syri i Vizionit” ndërtoi një kulturë të punës që sot rezulton me një ekspertizë solide.



Vlenë të vihet në pah se ky asociacion është i hapur për interakcion ideshë që shumë shpesh janë refleksion i ideve të qytetarëve kryesisht të rinj. Tashmë organizata jonë numëron mbi 150 anëtarë që ndihmojnë në mënyra të veçanta. Prej tyre rreth 60% janë të gjinisë femrore dhe 4 prej tyre vinë nga komunitetet jo-shqiptare.



Me një **Vizion**:

**Mendo Globalisht Vepro Lokalisht**

dhe me **Mision**:

**Synimin të rris bashkëpunimin e të rinjve nëpërmes lehtësimit të koordinimit të ideve dhe aktiviteteve që kanë dhe duan tyë bëjnë të rinjtë –**

Organizata jonë ka parashtruar **Objektivat**:

- Aftësimi i një gjenerate të re amatere në profesional
- Të zhvilloj në tërë Kosovën një ambient të tolerancës dhe një mirëbesim ndërmjet të rinjve

- Të inkurajoj shkëmbimin e ideve dhe opinioneve ndërmjet grupeve të rinj, respektimin e nacionaliteteve, racave dhe religjioneve të tjerëve.
- Të avokoj që të ketë më shumë të rinj pjesëmarrës në lëvizjet qytetare dhe institucionet publike që të është e mundur të dëgjohet zëri i të rinjve
- Të rrisë vetëdijesimin në mes të rinjve në hapësirë më të gjërë në temat sociale që kanë të bëjnë me kulturën, artin, sportin, ambientin, teknologjinë e re, ekonomi, turizëm,...
- Të avokoj për qytetarin
- Të avokoj për barazi gjinore dhe të drejtat e femrës
- Të avokoj për të drejtat e minoriteteve

### **Që me aktivitete si (të cilat janë në vazhdimësi e sipër):**

- Vazhdimësia e publikimit të revistës "Vizioni";
- Vazhdimësia e punës rreth koordinimit të Gazetës Avokuese "Kasneci";
- Shtimi i numrit të librave dhe anëtarëve të bibliotekës;
- Vazhdimi dhe shtimi i klasave me nxënës në kuadër të Shkollës së Gazetarisë;
- Vazhdimi i partneritetit dhe punës me Botues për Kosovë nfdaj Rrjetit "One World";
- Vazhdimi i punës në Monitorimin Kuvendit Komunal në Pejë, Istog në partneritet me KACI-n;
- Vazhdimi i bashkëkoordinimit të ideve të të rinjve, brenda dhe jashtë organizatës;
- Vazhdimi i bashkëveprimit me Rrjetin e të Rinjve të Pejës;
- Vazhdimi i bashkëveprimit me Rrjetin e të Rinjve të Kosovës;
- Realizimi i më shumë aktiviteteve që vijnë nga popullata e kryesisht nga të rinjtë;
- Marrja e aksioneve të ndryshme që shkojnë drejtpërsdrejti në të mirën e komunitetit;
- Hapjen e sa më shumë mundësive për trajnime të stafit dhe anëtarëve që punojnë për organizatën tonë;
- Koordinimi me organizata tjera si në vend dhe jashtë tij.

Një pjesë e Bordit të Organizatës kryen edhe punët e menagjimi në organizatën tonë:

### **Struktura organizative e Shoqatës:**

Veton MUJAJ – Kryetar i Organizatës - Koordinimi  
 Luan IBRAJ – Sekretar i Organizatës – Z/Koordinimi & Logjistika  
 Qenan BARDHAJ - Zyrtar i Financave - Z/Koordinimi & Administrata  
 Vlora LATIFI – Anëtari i Bordit të Drejtorve - mardhënje me jashtë  
 Nazlije KURBOGAJ - Anëtari i Bordit të Drejtorve – marëdhënjeve Brenda Organizatës



Mirlinda HYSAJ - Anëtari i Bordit të Drejtorve – Koordinator i projekteve të veqanta

Artan KASTRATI - Anëtari i Bordit të Drejtorve - Koordinator i projekteve të veqanta

Idriz SEFERI - Anëtari i Bordit të Drejtorve - Koordinator i projekteve të veqanta

Fatmir RAMAJ - Anëtari i Bordit të Drejtorve – Zëdhënës i organizatës



- Stafi dhe anëtarët e organizatës tonë deri me tani kanë kaluar nëpër shumë trajnime dhe punë në grupe, nga të cilat vlenë të cekën: Media, Menaxhimi i Konfliktëve, Barazia Gjinore, Avokimi, Strategji Planifikuese, Njohje mbi Shoqërinë Civile, Forcimi i

Shoqërisë Civile, Ndërtim të Ekipeve, Shruarje të Projekt Propozimeve, Planifikim Financiar, Zhvillim Organizativ, Hartim i projekteve sipas Objektivave, Ndalim të dukurive Negative në Shoqëri, Shëndet Reproductiv Seksual, Metoda Aplikuese, Formim të Grupeve Mirëpritëse, etj.

- Një pjesë e anëtarve të organizatës tonë kanë përvoja të posaqme të krijuara nëpër Organizata të ndryshme Ndërkombëtare, dhe me punën e tyre kanë bërë që gjendja në organizatën tonë të përmirësohet.
- Një pjesë tjetër e anëtarve është duke punuar në disa organizata ndërkombëtare, institucione të veqanta, media tjera të ndryshme, gjë që tregon për për efikasitetin e hapave të parë që po marrin në organizatën tonë.

Shumë nga aktivitetet e organizatës tonë janë përcjellur edhe nga media të ndryshme, ka pasur artikuj në mediat e shkruara më prestigjioze kosovare si: Koha Ditore, Zëri, Epoka e Re, Kosova Sot, ish-Dita, Zëri Javor – Pastaj emisione në Televizionin e Kosovës, Radio Kosova, Radio Dukagjini, Televizioni 21, TV Dukagjini, Radio Peja, radio UNMIK, KTV, e shumë media tjera.

### ***B) Projektet kryesore të zhvilluara gjatë vitit 2003***

- Për 12 muaj të vitit 2003 pra, **Janar – Dhjetor 2003** është bërë vazhdimësia e punës rreth gazetës avokuese Kasneci i Ri, në bashkë koordinim të organizatës tonë dhe OSBE-së.



- Në muajin **Gusht 2003**, 4 anëtar të oranzatës tonë i'u bashkangjitën këtij rrjeti në realizimin e Kampit në Ohër që kishte për qëllim



“Iniciativën për pajtim”, në grupe të veqanta të punës së 30 të rinjve nga Peja së bashku me 30 të rinj nga Kumanova, anëtarët e oranzatës tonë u kyqën dhe ishin bartës të shumë aktiviteteve atje, vlenë të cekët koordinimi për “revistën e kampit”.

- Organizata jonë ka realizuar informatorin me përmbajtje veprimtarin e afërsisht 45 organizatave të grave të rajonit të Pejës (Pejë, Istog, Deçan, Klinë) dhe është në tri gjuhë: Shqip, Serbisht dhe Anglisht..Ky informator ka dalë nga shtypi në gjysmën e muajit **Mars 2003**.
- 
- Është hapur Qendra Rinore “**zoom**” dhe kjo në koordinim me grupet e të rinjve OJQ “Syri i Vizionit”, Grupi i Alpinistëve “Marimangat”, Grupi i Teatrit dhe ai i Fotografisë. Ky projekt vazhdo të mbështetet nga organizata italiane “Trentino Con il Kosovo”. Organizata jonë në kuadër të Qendrës është duke koordinuar “Shkollën e Gazetarisë”, shkollë kjo 9 mujaore që realizohet në pesë faza:



**SHKOLLA  
E GAZETARISË**

**ONLINE**



**Faza e parë** ka pasur ligjerata nga lajmi e deri tek reportazhi, e cila ka zgjatur 4 muaj, studentët kanë arritur të krijojnë konceptin mbi gazetarinë klasike.

**Faza e dytë** ka pasur seminare dhe trajnime nga degët e ndryshme të gazetarisë si gazetaria kulturore, ekonomike, televizive me ligjërues nga media të ndryshme kosovare.

**Faza e tretë**, përmes seminareve dhe trajnimeve nga trajnerë që vijnë nga Italia do të njihen dhe praktikojnë gazetarinë moderne që njihet edhe si fazë e shkëmbimit gazetaresk.

**Faza e katërt** i takon gazetarisë informatike ku kryesisht do të punohet në një web faqe gazetareske.

Ndërsa në **fazën e pestë** dhe të fundit studentët do të kryejnë punë praktike gazetareske që është menduar të bëhet me realizimin nga vetë grupi, të një përmbledhjeje të gjithë asaj që kanë mësuar në një revistë-broshurë, realizimin e emisioneve të ndryshme në radio dhe televizione lokale, si dhe mbajtjen e web faqës gazetareske.

Me përfundimin e kësaj shkolle qyteti i Pejës do të ketë fushën e gazetarisë në një nivel më të avancuar edhe pse nxënës ka edhe nga pjesët tjera të Kosovës.

- Pas një ndërpreje të shkurtër të punës, duke parë interesimin e të rinjve për revistën "Vizioni", edhe pse kushtet nuk ishin shumë të volitshme organizata jonë në **Korrik 2003** ju vu punës në kthimin në jetë të kësaj reviste mujore për të rinj dhe tani **Tetor 2003** është në realizim e sipër numri i katërt pas ndalesës apo numri i 18 i kësaj reviste, që po realizohet komplet nga vetëkoordinimi dhe financimi ku janë përcaktuar edhe nevojat e egzistimit të kësaj reviste: Struktura e përgjithshme e shoqërisë kosovare është paksa patriarkale, ku gjeneratat e vjetra diktojnë rregullat e tyre tek të rinjtë, kryefshatarët dhe kryefisët shpesh definojnë prioritetet për një grup të gjërë njerëzish. Zakonet vendase madje edhe përforcohen këto struktura si dhe ligji komunist ende është i pranishëm në Kosovë, në kuptimin se shoqëria është shumë e orientuar kah statusi. Si rrjedhojë, shoqëria kosovare jo rrallë lejon shumë pak hapësirë për të rinjtë dhe femrat për të shprehur të drejtat e tyre të dëgjojnë zërat e tyre. Disa përmirësime kanë zënë vend gjatë viteve që lamë pas, në veçanti në periudhën e pasluftës në Kosovë 1998-99, por nevoja është ende e madhe për ndryshime drastike në mënyrën se si shoqëria integron rininë në Kosovë.



Qëllimi i revistës "Vizioni" është për një integrim më të mirë të të rinjve në shoqërinë e sotme, krijimin e një grupi bërthamë të të rinjve potencial si lider të komunitetit, që janë konkretisht të involvuar në bordin e redaksisë të revistës, në fushën e mediave të shtypura.

Anëtarët e "Syri i Vizionit" kanë fituar njohuri të gjërë dhe eksperiencë gjatë viteve 2000-03 në fushën e gazetarisë në botimin e 18 numrave të "Vizioni", koordinimin e botimeve të gazetës qytetare avokuese "Kasneci i Ri" në regjionin e Pejës si dhe punën që po bëhet në shkollën e gazetarisë.

"Syri i Vizionit" si dhe revista mujore është një hap vendimtarë për rinin kosovare me bazë nga një komunë siç është Peja që të qëndroj për të drejtat e tyre dhe mobilizojnë vetvetën e tyre për zhvillimin e projekteve të reja. Të rinjve në këtë mënyrë do tu ipet më shumë përgjithësi, jorespektimi apo jokopijimi i sociologjisë tradicionale ku të rinjtë janë lënë anash në çfarëdo procesi vendimmarrës. Qysh pas përfundimit të luftës revista për të rinj "Vizioni" ka qenë e vetmja medie e shkruar dhe e publikuar e dedikuar për të rinj, dhe ka qenë e shpërndarë në baza mujore në tërë Kosovën, për të shuar edhe në disa pjesë të Maqedonisë nga muaji **Shtator 2003**. Analizat e bëra në 2001 që të vlersojmë kapacitetin arritur të "Vizioni" ka dëshmuar suksesin e publikimit tonë dhe qëndrueshmërisë. Veç kësaj, aktivistët e rinj që kanë qenë të përfshirë në publikimin e revistes "Vizioni" qysh në fazate para

vazhdimisht kanë avokuar në barazinë gjinore dhe ka përfshirë një numër të madh në implementimin në e çfarëdo plani aktiv, bordi i redaksisë dhe 65 anëtarët e saj përbëhet prej 60% femra dhe 40% mashkuj.

Qysh në fillim të vitit 2001 revista e të rinjve "Vizioni" qëllim primar është të bëhet dhe të mbes. Lëshuar në baza mujore, i ka ofruar të rinjve kosovar analiza të thella dhe artikuj për brengat në fushat që kanë lidhje me të rinjt. Revista "Vizioni", do të shfrytëzohet dhe të kuptohet nga të rinjt si forum i hapur ku lirisht mund ti shprehin idet dhe opinionet e tyre. Tërsisht ti gëzoj të drejtat e veta, gjithashtu ti kuptoi obligimet qytetare në shoqëri që vazhdimisht ballafaqohet më ndryshime të reja.

Prej 2,000 kopjeve të të revistës "Vizioni", 5%-100 kopje janë ndarë anash për arkivin tonë për rritjen e fondeve në të ardhmën si dhe për kujtesën institucionale të asociacionit tonë. Revista zakonishtë përmbanë një mesatare prej 56 faqeve.

Gjatë **vitit 2003** janë realizuar 3 numra të kësaj reviste.

## OneWorld.net

- Gjatë Në **Shtator 2003** organizata jonë ka vënë partneritet me organizatën "One World" që është një organizatë mediale kompjuterike me seli nëpër të gjitha shtetet e botës, dhe organizatën tonë mbulohet me informacioni për territorin e Kosovës. Në këtë projekt është angazhur një nga anëtarët e organizatës. Ky projekt mendohet se do të ketë vazhdimësi afat-gjate.



- Ka vazhduar puna e përditshme me Rjetin e të Rinjve të Pejës dhe Rrjetin e të Rinjve të Kosovës, në shumë aktivitete.
- Poashtu gjatë tërë **vitit 2003**, janë shtuar librat në bibliotekën e organizatës tonë dhe po ashtu janë shtuar anëtarët të cilët kanë marrë libra.



### C) Raportet Financiare 2003

Raporti Financiar për vitin 2003 duket si në tabelen më poshtë

### D) Qëndrueshmeria

**Qëndrueshmëria:** Në termin e qëndrueshmëris materiale asociacioni jonë është i kënaqur me mjetet bazë që janë teknikishtë të nevojshme për menaxhimin dhe implementimin e projekteve, duke falemderuar mbështetjen nga USAID, pastaj organizata italiane CISP-i, KFOS-i, dhe

bashkëpunimi që bëhet me OSBE-në. Me ndihmën e dhënë nga anëtarët tanë dhe disa të hyra të vogla ne kemi mundur të gjenerojmë operimin e një biblioteke dhe një CD Klubi. Nga kjo kemi arritur të sigurojmë fonde që të paguajmë një pjesë të qirasë për zyret tona në qendrën e Pejës qysh prej fillimit të 2002. Nga kjo kemi arritur një nivel të kënaqshëm të qëndrueshmëris që vetëm disa asociacione në Kosovë i kanë, e gjithë kjo është duke i'u falemderuar angazhimit dhe mbështetjes vullnetare të anëtarve tanë. Zyra është e hapur çdo ditë prej të hënës deri të shtunën, shpenzimet e personelit janë shumë të vogla, 90% e punës është e kryer në baza vullnetare.

Vetëfinancimi jonë ka arritur që deri në fund të 2001 të ketë një tarifë deri në 80% . 20% të mbetura janë mbuluar nga koontributet ekstra dhe profite të marra në qendrën tonë nga biblioteka dhe CD Klubi.

Xhirollogaritë tona kanë qënë të balancuara dhe ne konsiderojmë vetën shumë të qëndrueshëm. Edhe pse një pjesë nga fondet tona është dashur që të dedikohën për borgjet, nga shpenzimet e paparashikueshme të incidentit në Shkurt 2002

#### **E) Prespektivat për vitin 2004**

- o Si prespektiv kryesore e OJQ "Syri i Vizionit" gjetja e zgjidhjes se si të hyrat vetanake të jenë shumë ma të larta se sa donacionet e pranuar.
- o Gjetjen e mundësisë për vazhdimin e publikimit të revistës "Vizioni"
- o Vazhdimsia e punës rreth koordinimit të Gazetës Avokuese "Kasneci i Ri"
- o Shtimi i numrit të libtave dhe anëtarve të bibliotekës
- o Shimi i numrit të CD-ve dhe anëtarve në CD-Club
- o Hapjen e një kursi gazetaresk
- o Vazhdimi i bashkëkoordinimit të ideve të të rinjve, brenda dhe jashtë organizatës
- o Vazhdimi i bashkëveprimit me Rrjetin e të rinjve të Pejës
- o Realizimi i më shumë aktiviteteve që vijnë nga popullata e kryesisht nga të rinjtë
- o Marrja e aksioneve të ndryshme që shkojnë drejtpërsdrejti në të mirën e komunitetit
- o Hapjen e sa më shumë mundësive për trajnime të stafit dhe anëtarve që punojnë për organizatën tonë.
- o Koordinimi me organizata tjera në vend dhe jashtë tij
- o Shtimin e anëtarve dhe pagesave nga ta për anëtarësim në OJQ "SiV"
- o Qëllimet e Organizates prap mbesin, vetëdijesimi i të rinjve për nevojën e involvimit të tyre në institucionet publike dhe në jetën shoqërore në përgjithësi, si dhe informimi i drejtë në aktivitete të ndryshme, ngjarje me rëndësi, demokraci, të drejta të njeriut, barazi gjinore, iniciativa të "liderëve të ardhshëm", përgjegjësitë e rinisë për ardhmërinë, arsimim, kulturë, art, sport, muzikë, ambient etj.